

VENDIM
Nr. 741, datë 12.12.2018

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË, TË NJË PJESE TË KATIT TË PARË DHE TË KATIT TË DYTË NË OBJEKTIN NR. 14, TË PRONËS NR. 12, ME EMËRTIM “KOMANDA E DOKTRINAVE DHE STËRVITJES”, ME VENDNDODHJE RRUGA E DIBRËS, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 3, të neneve 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Drejtësisë, për një periudhë 25-vjeçare të një pjese të katit të parë, me sipërfaqe 1057 (një mijë e pesëdhjetë e shtatë) m² dhe të katit të dytë, me sipërfaqe 1882 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) m², me sipërfaqe të përgjithshme 2939 (dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) m² në objektin nr. 14, të pronës së paluajtshme shtetërore nr. 12, me emërtim “Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes”, me vendndodhje Rruga e Dibrës, Tiranë, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për sistemimin me mjedise pune dhe ushtrimin e veprimtarisë së organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) etj.

2. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqeve të objektit të dhënë në përdorim të përkohshëm, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet të kryejë ndryshime infrastrukturore ose ndërtime të reja, në objektin e dhënë në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, pa miratimin paraprak të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Të drejtat dhe detyrimet e palëve duke përfshirë ruajtjen dhe sigurinë e pronës, mënyrën e zbatimit të rregullave të hyrje-daljeve të personelit dhe të mjeteve mënyrën e përdorimit e të mirëmbajtjes së rrjeteve inxhinierike, të linjave të komunikimit elektronik dhe të furnizimit me ujë, energji elektrike e linjave të tjera në përdorim të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të nënshkruhet marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes.


5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRIA E KATIT I

SUPERFAÇE PER DHE NIE PER PERDORIM 1057 M²




2005

The image shows a document page with a large, dark, irregular stain or smudge in the center. The document contains text and a table. The text is mostly illegible due to the stain and the quality of the scan. The table has several columns and rows, but the data is mostly obscured. The document is labeled 'A-01' in the top right corner.

MIRATOHEJ
KOMANDANTI I REPARTIT USHTARAK 6630

KOLONEL ARBEN KING, Jr.,



INSTRUMENTS

Figure 1. Map of the study area, photograph of the river, and photograph of the boat.